



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.1,
Korrik 2017

ATASHIMI ME PRINDËRIT DHE LIDHJA E TIJ ME SHFAQJEN E AGRESIVITETIT NË ADOLESHENCË

Bediana Brahillari*; Eglantina Dervishi*

*Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: bedianabrahollari@yahoo.com

Përmbledhje

Objektivi: Objektivi kryesor i këtij punimi është të shpjegojë dhe të eksplorojë lidhjen e atashimit me prindërit dhe shfaqjen e agresivitetit tek adoleshentët. Adoleshenca konsiderohet si një periudhë tranzicioni e rëndësishme për shkak të ndryshimeve njohëse, biologjike dhe sociale që ndodhin gjatë kësaj periudhe kohore. Studime të mëparshme kanë treguar se mungesa e marrëdhënieve të mira familjare është e lidhur me shfaqjen e problemeve në sjellje nga adoleshentët. Në këtë kuptim, është vërtetuar që problemet e atashimit midis prindërve dhe fëmijëve, si mungesa e një komunikim të mirë dhe një marrëdhënie ofensive e rëndë midis tyre, çojnë drejt shfaqjes së sjelljeve të papërshtatshme, duke përfshirë agresionin fizik, verbal, armiqtësinë dhe zemërimin.

Metoda: Në këtë punim është përdorur metodologjia cilësore për të shqyrtuar të dhënat nga literatura dhe studimet metaanalitike mbi marrëdhënien e adoleshentëve me prindërit dhe shfaqjen e sjelljeve agresive në mjedisin ku ata jetojnë.

Rezultatet: Kjo trajtesë e analizuar përmes të dhënave shpjeguese dhe mikroanalitike na paraqet ndikimin e kontekstit familjar në shfaqjen e predispozitës së adoleshentëve për t'u përfshirë në sjellje agresive.

Konkluzione: Në përfundim do të paraqiten një sërë gjetjesh të cilat lidhen me rëndësinë e madhe të analizimit të kontekstit familjar si një burim i zhvillimit dhe të mësuarit të aftësive, por edhe me ndërgjegjësimin se marrëdhëniet jo të mira në familje janë faktor risku që predisponon të përgjigjurit me agresivitet dhe në mënyrë të papërshtatshme.

Fjalë çelës: atashim, agresivitet, adoleshencë.

THE RELATIONSHIP BETWEEN PARENTAL ATTACHMENT AND ADOLESCENT AGGRESSIVE BEHAVIOUR

Abstract

Objective: The main objective of the present study is to explain and explore the relation of attachment to parents and the appearance of aggression among adolescents. Adolescence is considered a significant transition period due to cognitive, biological, and social changes occurring during this period of time. Previous studies have shown that lack of good family

relationships is related to the emergence of adolescent behavioral problems. In this sense, it has been proven that the problems of attachment between parents and children, such as lack of good communication and a serious offensive relationship, lead to the appearance of inappropriate behaviors including physical aggression, verbal, hostility and anger.

Method: The present study uses qualitative methodology to review data from literature and metaanalytical studies on adolescent relationships with parents and the appearance of aggressive behaviors in the environment where they live.

Results: This treatment, analyzed through explanatory and microanalytic data, presents the impact of the family context on the emergence of teenage predispositions to engage in aggressive behavior.

Conclusions: In conclusion, a series of findings that relate to the importance of analyzing family context as a source of development and learning skills, as well as raise the awareness that poor family relationships are a risk factor that predisposes responding with aggressiveness as well as inadequate.

Key words: *attachment, aggression, adolescence.*

Hyrje

Ndryshimet e shpejta neurologjike, njohëse dhe sociale të adoleshencës krijojnë një dilemë social-njohëse për të rinjtë në integrimin e përvojave të reja dhe të ndryshme në lidhje me botën dhe veten. Adoleshenca gjithashtu paraqet (1) një dilemë afrimiteti, pasi ruhen lidhjet me prindërit, por në të njëjtën kohë adoleshentët eksplorojnë role të reja shoqërore larg nga familja dhe zhvillojnë marrëdhënie të reja afrimiteti me shokët. I një rëndësie të madhe është fakti se tranzicioni i suksesshëm i adoleshencës nuk arrihet përmes shkëputjes nga prindërit. Në fakt, kalimi i shëndetshëm drejt autonomisë lehtësohet nga atashimi i sigurt dhe lidhja emocionale me prindërit. Me pak fjalë, studimet tregojnë se lidhja e sigurt në adoleshencë nxit bazën e një sigurie eksploruese dhe zhvillimin e kompetencave njohëse, sociale dhe emocionale.

Adoleshentët me lidhje të sigurt gjithashtu vuajnë më pak nga probleme të shëndetit mendor, si: ankthi, depresioni, kriminaliteti dhe agresioni. Atashimi i sigurt është shumë i rëndësishëm për përshtatjen e shëndetshme të adoleshentit. Agresioni, dhuna dhe sjellja antisociale në adoleshentët janë ndër shqetësimet kryesore në shumë vende të zhvilluara. Kostoja sociale dhe ekonomike e dhunës dhe sjelljes antisociale është e konsiderueshme dhe në rritje. Afërsisht gjysma e të gjithë problemeve të sjelljes agresive serioze janë vërejtur për herë të parë në adoleshencë (2). Provat tregojnë se ndërhyrjet të cilat përmirësojnë cilësinë e marrëdhënieve prind-adoleshent, janë të lidhura me reduktimin e problemeve të sjelljes dhe përmirësimin e shëndetit mendor dhe rezultatet arsimore (3).

Teoricienët e kanë kuptuar prej kohësh rëndësinë e atashimit si një dukuri universale zhvillimore. Roli i atashimit në zhvillimin e foshnjave është identifikuar dhe përshkruar si një përvojë themelore në zhvillimin njerëzor (4). Siç përshkruhet nga Bowlby (5), sjelljet atashuese duhet të organizohen në mënyrë progresive gjatë muajve të parë të jetës, në mënyrë që të sigurohet afërsia midis nënës dhe fëmijës dhe për të motivuar nënën në kujdesin ndaj fëmijës. Brenda kontekstit të një marrëdhënieje të sigurt nënë - fëmijë, fëmija në zhvillim është në gjendje të eksplorojë mjedisin social me besim. Kur fëmija ballafaqohet me pasiguri, rrezik apo stres, marrëdhënia e sigurt i ofron një strehë sigurie dhe rehatie. Nga kjo marrëdhënie e sigurt prind - fëmijë, fëmija është në gjendje të ndërtojë modele të qëndrueshme të bashkëveprimit me mjedisin, me veten dhe me persona të rëndësishëm rreth tij. Pra modelet e brendshme të funksionimit manifestohen gjatë gjithë jetëgjatësisë së individit dhe ndikojnë në cilësinë e sjelljeve adaptive në adoleshencë.

Përcaktimi i problemit

Shfaqja e agresivitetit nga adoleshentët në ditët e sotme përbën një problem shumë shqetësues për mbarë shoqërinë tonë. Duke vijuar në këtë linjë është ndërmarrë ky punim, i cili kërkon të mbledhë më shumë informacion rreth studimeve të mëparshme për atashimin me prindërit dhe agresivitetin e shfaqur prej tyre në shkollë. Më tej, është synuar të shqyrtohet lidhja midis dy dimensioneve, atij të atashimit dhe agresivitetit të shfaqur nga adoleshentët.

Atashimi me prindërit

Atashimi është formimi i lidhjeve emocionale të qëndrueshme midis nënës dhe fëmijës. Kjo lidhje emocionale fillon të zhvillohet që prej ditëve të para pas lindjes. Kulmin e arrin diku në moshën prej 18 deri 30 muajsh të jetës. Ai është një proces që ndodh me kalimin e kohës dhe që përfshin një marrëdhënie reciproke afeksioni midis tyre. Në periudhën 6-8 muajsh, kur foshnjat shohin një të panjohur, hidhen në krahët e nënës dhe nuk ndahen prej saj. Në këtë periudhë ato përjetojnë atë që quhet ankthi apo frika nga i huaji. Në moshën 18 muajsh - 2-vjeçare ato përjetojnë ankth kur nëna nuk është aty. Shfaqja e këtij ankthi sugjeron se foshnjat kanë një të kuptuar të qartë të faktit se nëna ekziston, edhe pse nuk është aty. Atashimi është një ndërveprim i bukur dhe harmonik. Kjo lidhje mbjell farat e lidhjeve sociale dhe komunitare, lidhje të cilat janë shumë të rëndësishme (6). Marrëdhënia sociale më e parë dhe më jetike, që përjeton njeriu në jetën e tij, është marrëdhënia nënë - fëmijë.

Për të përshkruar rëndësinë e atashimit, do të thoshim se është i një rëndësie jetike për fëmijën, sepse ai mund të ndikojë në zhvillimin psikologjik dhe social të fëmijës. Kërkimet shkencore kanë treguar se fëmijët të cilët kanë qenë të lidhur ngushtë me nënën në foshnjëri, rriten duke qenë më kompetentë në disa shprehje sociale dhe njohëse: ata janë më kureshtarë, bashkëpunojnë më shumë me të tjerët, janë më të aftë, më të prirë për të marrë vendime dhe për t'u vetudhëhequr, më të pavarur se ata të cilët kanë patur një atashim të dobët. Ata, gjithashtu, janë të prirur të kërkojnë për shoqëri nga të tjerët dhe zgjidhen për t'u bërë udhëheqës. Në shkollë, ata ndërveprojnë me mësuesit në mënyrë miqësore dhe të përshtatshme, dhe ka më shumë të ngjarë të jenë më të pavarur, duke u kërkuar ndihmë mësuesve vetëm atëherë kur duhet. Janë më të aftë për të zgjidhur problemin, janë më kureshtarë në moshën parashkollore, shprehin më shumë afinitet për lojërat simbolike, më shumë entuziazëm në lojë, kanë tendencë të reagojnë më shumë kur nëna afrohet dhe ngjiten pas saj, dhe gjithashtu, janë më pak agresivë (6). Përkundrazi, fëmijët të cilët kanë patur një atashim të dobët, janë më të prirur për të përjetuar më shumë vështirësi në këto fusha dhe këto pasoja mund të mbarten edhe në vitet që pasojnë. Është zbuluar se atashimi i dobët është një nga faktorët në ekuacionin që shpjegon problemet që shfaqen në adoleshencë, të tilla si: agresiviteti, kriminaliteti, shtatzënia në adoleshencë, përdorimi i drogës dhe i alkoolit, dhe të tjera.

Një zbulim tjetër i kërkimeve shkencore është se marrëdhënia nënë - fëmijë dhe ndikimi reciprok kanë role kyçe dhe përbëjnë parametrat më efektivë që ndikojnë procesin e rritjes së shpejtë dhe shumëdimensionale të fëmijës (6). Marrëdhënia nënë - fëmijë, duke qenë se është marrëdhënia më e ngushtë, më intensive dhe më ndikuese, është e pashoqe. Nëna ka një ndikim përcaktues dhe jetëgjatë mbi karakteristikat psiko-sociale të fëmijës gjatë procesit të edukimit. Forca, thellësia dhe vazhdimësia e atashimit do të mjaftonin për të shpjeguar ndikimin përcaktues të nënës. Rëndësia e madhe e atashimit të nënës me fëmijën shihet edhe në faktin se faza më e efektshme edukative në transmetimin e kulturës tek brezi i ri, është periudha intensive e të mësuarit gjatë fëmijërisë, kur fëmija përjeton marrëdhënie fytyrë më fytyrë në atmosferën emocionale të familjes.

Çrregullimet e atashimit i karakterizon mungesa apo devijimi i lidhjes që zhvillohet normalisht midis fëmijës dhe nënës. Ato vijnë si rezultat i kujdesit të pamjaftueshëm apo të pakënaqshëm në fëmijërinë e hershme. Vlen të theksohet se çrregullimet e atashimit ndikojnë negativisht në zhvillimin

e ndjenjave të dashurisë tek fëmija ndaj të afërmeve të tij. Nëse për rrethana të caktuara shkohet deri tek mungesa e lidhjes emocionale në moshë të hershme, kjo nuk i mundëson fëmijës që të krijojë një vetërespekt pozitiv apo vetëvlerësim, aftësinë sociale, si dhe ndjenjën e sigurisë tek tjetri.

Winicot (psikanalist anglez) (7) në punimin vet ontologjik, “Preokupimi i parë i nënës”, dëshmon se çdo mungesë të kujdesit të nënës në periudhën e hershme fëmija e përjeton si rrezik për ekzistencën e vet. Winicot në literaturë solli termin “mbajtje” e fëmijës, si entitet i veçantë, i cili i përket gjithanshmërisë së kujdesit të nënës në moshën kur fëmija është në varësi fizike dhe psikologjike nga ajo. Winicot thekson se “mbajtja” si nocion përfshin mbajtjen fizike të fëmijës, të cilën e quan si formë e dashurisë. Ka nëna që mund ta mbajnë fëmijën dhe të tjera që nuk mund ta mbajnë.

Teoria e Ainsworth (8) vuri në dukje se përvoja e atashimit të sigurt ofron një bazë nga e cila fëmija hulumton botën dhe zhvillon kompetencat ndërpersonale. Përgjigjja e duhur prindërore ndaj nevojave të fëmijës çon në atashim të sigurt, ndërsa përgjigjja prindërore e çrregullt dhe devijuese nga lidhja çon në nivel atashimi të pasigurt dhe mesatar.

Dimensionet e Atashimit

Bazuar te Armsden dhe Greenberg (9) ekzistojnë tre dimensionet e atashimit: komunikimi, besimi dhe inati (largimi, izolimi). Shumica e studimeve fokusohen te komunikimi dhe atashimi. Më pak studime ekzaminojnë marrëdhënien midis besimit edhe atashimit, dhe inatit me komunikimin.

Komunikimi. Komunikimi i ndërsjellë midis prindërve edhe fëmijëve ka qenë fokusi i shumicës së kërkimeve në këtë fushë. Më specifikisht, Segrin dhe Flora (10) pohojnë se komunikimi i përbashkët dhe aspekte të tij ndihmojnë në krijimin e lidhjeve të forta midis prindërve edhe fëmijëve. Për më tepër, këto marrëdhënie të forta prind - fëmijë janë të rëndësishme për gjithë jetën. Adoleshentët e kërkojnë komfortin edhe afërsinë në formë këshille kur e ndiejnë se kanë nevojë (11). Kështu që komunikimi mund të jetë shumë i rëndësishëm në adoleshencë. Gjatë adoleshencës, marrëdhënia e prindit me fëmijën varet nga aftësia që zhvillohet nga fazat e hershme dhe konflikti që ndihmon distancën në adoleshencë në sens psikologjik, prej prindërve (12).

Besimi. Ky dimension mund të përcaktohet si ndjenja dhe besime të sigurta se një person tjetër do të përmbushë nevoja të caktuara të tuat. Besimi është produkt i marrëdhënieve të forta, specifikisht në ato marrëdhënie ku individët besojnë se mund të mbështeten te njëri-tjetri. Fëmijët e ndërtojnë besimin në marrëdhënie duke mësuar se të tjerët janë në mënyrë të qëndrueshme atje për ata. Pra aftësia për të besuar se figura atashuese ekziston për shkak të situatave pozitive në të shkuarën që lidheshin me besimin. Nuk ka rëndësi se kush është figura atashuese, adoleshentët duan të ndiejnë se ata janë afër dikujt që mund t'i besojnë (13).

Inati. Ky dimension lidhet shumë ngushtë me shmangien dhe refuzimin, dy konstrukte që janë shumë të rëndësishme për sigurinë në adoleshencë. Kur dikush thotë që figura atashuese nuk është e disponueshme, atashimi bëhet më pak i sigurt, bazuar në ndjenjat e inatit. Nuk ka shumë studime mbi këtë pikë. Por është e rëndësishme të eksplorohehen ndjenjat e inatit në atashim.

Sjelljet agresive

Agresiviteti si koncept është i vështirë për t'u përkufizuar. Ai përdoret dhe keqpërdoret gjerësisht. Psikologu social Baron (14) e përkufizoi agresivitetin si një sjellje që synon të dëmtojë një anëtar tjetër të të njëjtit lloj. Ky përkufizim përjashton agresivitetin midis llojeve (gjuetinë), agresivitetin e rastësishëm dhe agresivitetin ndaj objekteve të mjedisit. Sjellja agresive mund të marrë forma të shumta. Ajo mund të jetë sjellje fizike, si: sulmi me grushte ose armë; sjellje verbale, e tillë si kërcënimet; ajo mund të jetë një veprim i tërthortë, si shkatërrimi i pronës së armikut ose dëmtimi i të dashurve të tij.

David Mayers (15), përmend disa arsye të shkaktimit të sjelljeve agresive. Një nga to ai përmend “shpërblimin që sjell agresiviteti”, duke aluduar në përfitimet e mundshme që mund nxjerrë shkaktuesi i sjelljeve të dhunshme brenda shoqërisë, si frikësimin të tjerëve për realizimin e qëllimeve të caktuara, madje edhe dëmtimin fizik ose psikik. Sipas tij kjo zakonisht ndodh nga ndikimi i tre faktorëve të jashtëm, të cilët ndikojnë në ndërtimin e bindjeve dhe qëndrimeve të caktuara, që pastaj shfaqen edhe në sjellje të caktuara, të cilat zakonisht janë agresive. Mayers, në këtë rast përmend tre faktorë që ndikojnë në këtë sjellje të fëmijëve: familja, subkultura dhe masmedia (15). Zakonisht fëmijët mund të jenë të nxitur për të shkaktuar akte të dhunshme karshi bashkëmoshatarëve të tyre edhe në bazë të ndikimit nga këta faktorë. Meqenëse dy rrafshet e fundit duken shumë të pranueshme, familja në këtë rast kërkon më tepër elaborim, pasi të rralla mund të jenë rastet kur familjarët mund të nxisin fëmijët e tyre për të bërë akte agresive dhe të dhunshme në rrethin shoqërorë ku ata kalojnë shumë kohë, por që në specifikën e shoqërisë tonë kjo mbase edhe mund të jetë shumë e pranishme. Për këtë Mayers thotë se fëmijët që kanë prindër ndëshkues kanë prirje për t’u sjellë agresivisht me të tjerët. Prindërit e tyre zakonisht i dispiplinojnë me britma, shuplaka ose rrahje – duke e bërë agresionin një mënyrë për t’u përballur me gjërat (15).

Teoria e të mësuarit social

Për shpjegimin e sjelljeve agresive teoria reaktive luan një rol të rëndësishëm. Bandura (16) është i mendimit se sjellja agresive është rezultat i të mësuarit nëpërmjet observimit dhe imitimit. Imitimi i sjelljes agresive do të varet nga fakti nëse modeli i observuar ka apo jo përfitim pozitiv nga shfaqja e agresivitetit të tij. Nëse ka përfitime, atëherë rritet mundësia e imitimit, por nëse modeli ndëshkohet, atëherë ulet probabiliteti i imitimit. Modele të tilla janë prindërit.

Duke u rikthyer në dhunën tek adoleshentët, është konstatuar që prindërit e adoleshentëve agresivë janë prindër të cilët e tolerojnë dhunën, nuk ndëshkojnë sjelljen agresive dhe me raste, edhe e mbështesin. Ndërsa në shkollë adoleshentët kryejnë këto sjellje agresive të mësuar dhe përfitojnë benefite sociale të tilla si respekti apo popullariteti, gjë e cila rrit më tepër mundësinë që kjo sjellje të vazhdojë të përsëritet.

Klasifikimi i dhunës

Dhuna përcaktohet si sjellje që presupozon përdorimin e metodave të ndryshme për t’i bërë keq të tjerëve, ose për të plotësuar interesat e vetë individit (15). Klasifikimi më i përshtatshëm mbi tipet e sjelljes dhunuese bazohet në dimensionin sjellor të dhunës.

- Dhuna hostile ka të bëjë më një sjellje e cila është impulsive dhe jo e planifikuar, e mbushur me inat, por që lind si reagim ndaj një provokimi.
- Dhuna instrumentale përfshin dimensionin e qëllimshëm për të arritur diçka dhe për të plotësuar interesat personale dhe nuk shihet si një reagim ndaj një agresioni të mundshëm.

Klasifikime të tjera më të shpeshta të sjelljes dhunuese bëjnë një dallim të dyfishtë duke diferencuar *forma të shumëllojshme të dhunës*, p.sh.: dhuna e drejtpërdrejtë fizike, por mund të manifestohet edhe si jodirekte verbale ose racionale. Por gjithashtu dhe funksione të ndryshme të dhunës, p.sh. mbrojtje kundrejt ofendimit i cili përfshin dhunën hostile, ose dhuna instrumentale për të arritur objektivat.

Shfaqja e agresivitetit gjatë periudhës së adoleshencës

Dhuna është një sjellje agresive me synimin që të shkaktojë dëmtim fizik ose psikik tek tjetri. Kjo lloj sjelljeje kur fillon e aplikohet në brendinë e institucioneve arsimore merr formën e dhunës në

shkolla ose e sjelljeve të shumta agresive të nxënësve në shkolla. Kjo trajtë bëhet shumë shqetësuese kur pikërisht nxënësit janë ata që projektojnë këto qëllime dashakeqëse për bashkëmohatarët e tyre. Një adoleshent shpesh është i dhunshëm edhe në shkollë dhe mënyra e tij e të sjellurit supozon mosplotësimin e normave shkollore dhe sociale që rregullojnë ndërlidhjet me klasën dhe institucionin dhe me shprehjen e sjelljeve të ndryshme dënuese për të tjerët (10) që përfshin agresion të manifestuar proaktiv ose reaktiv dhe që u binden arsyeve të ndryshme.

Përfundime

Sipas Mayers (17) “konteksti familjar është mjaft i rëndësishëm, ai shihet si burim i zhvillimit dhe të mësuarit të aftësive gjatë jetës, por gjithashtu, nëse marrëdhëniet midis anëtarëve nuk janë të mira, atëherë ky është faktori kryesor i të rrishtuarit të adoleshentëve në përfshirjen e sjelljeve agresive apo të papërshtatshme”.

Në këtë kuptim, në investigime të ndryshme është konstatuar që lidhjet familjare pozitive janë karakterizuar nga një kohezion pozitiv midis prindit dhe fëmijës, mbështetja, besimi, intimiteti midis tyre, komunikimi i hapur dhe emptik favorizon zhvillimin sjellor të psikologjisë së fëmijës, dhe në të kundërt, lidhja familjare negative është një kontekst ku nuk ekziston asnjë prej komponentëve të përmendur, gjë që shihet si një nga faktorët e riskut më të drejtpërdrejtë të lidhur me problematikën te fëmijët dhe adoleshentët.

Përgjatë punimeve të ndryshme në lidhje me shfaqjen e agresivitetit nga adoleshentët me atashim të pasigurt, është vënë re se lidhja e sigurt në adoleshencë nxit bazën e një sigurie eksploruese dhe zhvillimin e kompetencave njohëse, sociale dhe emocionale (12). Studimet e mostrave klinike tregojnë se adoleshentët me lidhje të sigurt kanë më pak gjasa të angazhohen në sjellje agresive, në përdorimin e tepruar të pijes, në përdorimin e drogës dhe sjellje të rrezikshme seksuale. Adoleshentët me lidhje të sigurt gjithashtu vuajnë më pak nga probleme të shëndetit mendor, si: ankthi, depresioni dhe kriminaliteti e agresioni. Gjetjet nga mostrat klinike janë në përputhje me ato nga mostrat normative: lidhja e pasigurt është e lidhur me sjelljen agresive dhe delikuyente.

Referenca

1. Ainsworth, M. D. S., Blehar, M. C., Waters, E., & Wall, S. (1978). Patterns of attachment: A psychological study of the strange situation. Hillsdale, NJ: Erlbaum.
2. Armsden, G. C., & Greenberg, M. T. (1987). The inventory of parent and peer attachment: Individual differences and their relationships to psychological well-being in adolescence. *Journal of Youth and Adolescence*, 16.
3. Arnold, M. L., Pratt, M. W., & Hicks, C. (2004). Adolescents' representations of parents' voices in family stories: Value lessons, personal adjustment, and identity development. In M. Pratt & B., 211-214.
4. Baron, R. A. (1983). The control of human aggression: An optimistic perspective. *Journal of Social and Clinical Psychology*, 1(2), fq. 97.
5. Bowlby, J. (1969). Attachment, Vol. 1 of Attachment and loss. London: Hogarth Press. New York: Basic Books; Harmondsworth: Penguin (1971) 219-221.
6. Bowlby, J. (1988). A secure base: Parent-child attachment and healthy human development, New York: Basic Books 34-48.
7. Broidy, L. M., Nagin, D. S., Tremblay, R. E., Bates, J. E., Brame, B., Dodge, K. A., ... & Lynam, D. R. (2003). Developmental trajectories of childhood disruptive behaviors and adolescent delinquency: a six-site, cross-national study. *Developmental psychology*, fq. 39.

8. Kazdin, A. E., & Weisz, J. R. (1998). Identifying and developing empirically supported child and adolescent treatments. *Journal of consulting and clinical psychology*, fq. 66.
9. Laursen, B., & Collins, W. A. (2004). Parent-child communication during adolescence. In A. L. Vangelisti (Ed.), *Handbook of family communication*. Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum Associates 354-362.
10. Moretti, M. M., & Peled, M. (2004). Adolescent-parent attachment: Bonds that support healthy development, fq. 66, 67.
11. Noller, P. (1994). Relationships with parents in adolescence: Process and outcome. In R. Montemayor, G. Adams, & T. Gullotta (Eds.), *Personal relationships during adolescence*. Thousand Oaks, CA: Sage 70-101.
12. Pettijohn, T. F. (1996). Psikologjia nje hyrje koncize (Adoleshenca dhe agresiviteti). Botimi 2. Shtëpia botuese: Lilo. 67-89.
13. Reese, S. D. (2008). Theorizing a globalized journalism. *Global journalism research: Theories, methods, findings, future*, fq. 240-242.
14. Segrin, C., & Flora, J. (2005). *Family Communications*. Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, 231-241.
15. Mayers, D. Social psikologjia, përktheu Enian Çela, Tiranë, Uegen, 2003, (fq. 357).
16. Bandura, A. (1976). *Social learning analysis of aggression*: Penguin 123-131.
17. Ulrich Mayer, K. (2004). Whose lives? How history, societies, and institutions define and shape life courses. *Research in human development*, 213-243.
18. Vermande, M. M., Van den Oord, E. J., Goudena, P. P., & Rispens, J. (2000). Structural characteristics of aggressor-victim relationships in Dutch school classes of 4-to 5-year-olds. *Aggressive Behavior*, fq. 11.
19. Winnicott, D. W. (2004). *Mirror-role of mother and family in child development*.